



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KPM-2014/01

Në mbështetje të nenit 3.2.6 dhe nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM nxjerr këtë:

RREGULLORE PËR VLERËSIMIN E APLIKACIONEVE PËR LICENCË TË KPM-së

NENI 1 Qëllimi

Rregullorja për aplikantët që parashtrojnë kërkesa për frekuenca të reja radio dhe televizione siguron një vlerësim të drejtë, të hapur dhe llogaridhënës, në mënyrë që të përzgjidhet kandidati më i mirë për licencë.

NENI 2 Fushëveprimi

Rregullorja përcakton mënyrën e vlerësimit të aplikacioneve me qëllim të përzgjedhjes së kandidatit për licencë të KPM-së i cili është më i përgatituri që të operojë si shërbyes medial audio-vizuel (Radio apo TV), dhe që ofron program cilësor që i përmbush nevojat e qytetarëve në zonën ku shërben.

NENI 3 Përkufizimet

1. **Parashtruesi i kërkesës:** është çdo subjekt që bën kërkesë për licencë të KPM-së ose që kërkon miratim për transferimin e një licence ekzistuese ose miratimin për marrjen e një pjese të pronësisë tek një i licencuar ekzistues.
2. **Personi i autorizuar:** është një individ që përfaqëson dhe zbaton udhëzimet e një pale të tretë, por jo edhe në emër të një organizate politike.
3. **Licencë:** është leje kontraktuale e dhënë nga KPM-ja për shërbime mediale audio-vizuele. Licenca e obligon të licencuarin që të veprojë në pajtim me Ligjin e KPM-së dhe ligjet tjera relevante të zbatueshme në Republikën e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e KPM-së si dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së.

4. **Shërbimi medial audio-vizuel** – nënkupton një shërbim i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore (person fizik apo juridik) dhe parim kryesor i të cilit është ofrimi i programeve, me qëllim që të informojë, argëtojë apo edukojë gjithë publikun, përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike. Një ofrues i tillë i shërbimeve mediale audio-vizuale është transmetues televiziv apo video me kërkesë;
5. **Transmetimi televiziv** – nënkupton një shërbim medial audio-vizuel linear i ofruar nga ofruesi i shërbimit medial për shikim të njëkohshëm të programeve, në bazë të një orari të caktuar të programit.
6. **Radio transmetimi** – nënkupton një shërbim linear medial radio, të ofruar për dëgjim të programeve në bazë të një orari të caktuar të programit;
7. **Shërbimi medial radio** – nënkupton një shërbim i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimit medial radio, parim kryesor i të cilit është ofrimi i programeve, me qëllim që të informojë, argëtojë apo edukojë gjithë publikun, përmes rrjetave të komunikimeve elektronike. Shërbimi medial radio është një radio transmetim apo një shërbim medial radio me kërkesë, apo/edhe komunikim komercial në shërbimet mediale radio;
8. **Ofrues i shërbimit medial** – nënkupton personin fizik ose juridik i cili ka përgjegjësi editoriale për përzgjedhjen e përmbajtjes audio-vizuale apo radio, dhe i cili përcakton mënyrën në të cilin ajo organizohet apo paraqitet;
9. **Transmetues televiziv** – nënkupton një ofrues të shërbimit medial të transmetimeve televizive;
10. **Radio transmetues** – nënkupton një ofrues të shërbimit medial të radio transmetimeve;

NENI 4 **Procesi i vlerësimit**

1. Vlerësimi nga Komisioni i KPM-së do të bëhet në bazë të të dhënave të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, fillimisht në fletë-aplikacionin e kompletuar, që janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara.
2. Dokumentacioni i konkursit dorëzohet në zarf të mbyllur (2 kopje). Zarfi do të hapet para komisionit përkatës të KPM-së
3. Aplikacioni i pakompletuar sipas konkursit, nuk do të shqyrtohet.
4. KPM-ja, pas vlerësimit të aplikacionit në pajtueshmëri me kriteret e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin e KPM-së si dhe me këtë Rregullore, do t'i lëshojë licencë

parashtruesit të kërkesës, në bazë të sistemit të vlerësimit. Maksimumi i pikëve për plotësimin e të gjitha kriterëve është 100 pikë.

5. KPM-ja, do t'ia lëshojë licencën parashtruesit të kërkesës i cili ofron informacione të qarta dhe të sakta, për të gjitha kriteret e KPM-së, dhe që merr më së shumti pikë gjatë vlerësimit të aplikacionit.
6. Parashtruesi i kërkesës, që nuk arrin të plotësojë njërin nga kriteret e përgjithshme të përcaktuara nga KPM, gjatë vlerësimit të aplikacioneve do të diskualifikohet nga Komisioni i KPM-së.
7. Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve, në përbërje të stafit të Zyrës Ekzekutive dhe Anëtarëve të Komisionit, do të caktohet me një vendim të veçantë të KPM-së.

NENI 5

Kriteret për vlerësim të aplikacioneve

1. Në pajtim me nenin 22 të Ligjit të KPM-së, me rastin e vlerësimit të aplikacioneve të parashtruara për licencat e transmetimit, KPM-ja do të merr parasysh kriteret e mëposhtme:

1.1 Kapaciteti për zhvillimin e programit vetanak dhe nevoja për të siguruar program të shumëllojshëm për të gjithë qytetarët në atë zonë të mbulimit. :

- a) Formatit dhe skema programore e propozuar, duke marrë parasysh kërkesën për atë shërbim;
- b) Struktura e programit;
- c) Sasia e programit lokal të prodhuar nga parashtruesi i kërkesës;
- d) Lloji i programeve të prodhuar nga parashtruesi i kërkesës;
- e) Natyra dhe karakteri i programit të prodhuar;
- f) Sasia e programeve informative në shërbim të publikut që jeton brenda zonës së mbulimit me sinjal nga ana e parashtruesit të kërkesës për licencë të KPM-së;
- g) Dëshmi mbi aftësitë profesionale për të themeluar një subjekt transmetues;
- h) Dëshmi mbi aftësitë për të menaxhuar një subjekt transmetues;
- i) Struktura organizative;
- j) programet të cilat pasqyrojnë shumëllojshmërinë gjuhësore në atë zonë të mbulimit

Numri maksimal që mund të arrihet për plotësimin e këtij kriteri është 40 pikë

1.2 Kushtet teknike:

- a) Projekti teknik i sistemit të transmetimit
- b) Cilësia e teknologjisë së propozuar për transmetim;
- c) Cilësia e teknologjisë dhe standardet e propozuara të punës në studio.

- d) Lidhur me nënpikat a), b) dhe c) të këtij neni, komisioni përkatës i KPM-së, do ta verifikojë gjendjen në terren.

Numri maksimal që mund të arrihet për plotësimin e këtij kriteri është 30 pikë

1.3 Qëndrueshmëria financiare :

- a) Dëshmi mbi burimet financiare (garanci bankarë; dëshmi mbi donacione apo të ngjashme);
b) Paraqitja e një plan biznesi të qartë për organizimin dhe zhvillimin e një shërbimi medial audio-vizuel;

Numri maksimal që mund të arrihet për plotësimin e këtij kriteri është 30 pikë

1.4 Respektimi i rregulloreve të KPM-së

- (a) nuk ka pasur shkelje të mëparshme të rregulloreve të KPM-së = 0 pikë
(b) çdo kërkesë për kërkim falje publike, vërejtje apo urdhëresë = minus 10 (dhjetë) pikë
(c) çdo gjobë = minus 20 (njëzet) pikë
(d) çdo suspendim i licencës ose urdhër për mbylljen e stacionit = minus 30 (tridhjetë) pikë

1.5 Në rast se pas poentimit, dy apo më shumë aplikant kanë pikë të barabarta, atëherë fiton kandidati që ka më shumë pikë tek pjesa programore. Nëse aplikuesit kanë prapë pikë të njëjta, atëherë kandidatët do të intervistohen.

NENI 6 Vendimet e Komisionit

Vendimet e KPM-së lidhur me vlerësimin e aplikacioneve, do të bëhen publike në pajtim me nenin 23, paragrafi 3 dhe 4, të Ligjit të KPM-së.

NENI 7 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

Adnan MEROVCI

Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



Data:

25.12.2014